



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 04.09.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 01.09.2020, të parashtruar nga Operatori Ekonomik “DWH ALBANIA” sh.p.k., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me pajisje të instrumentit GPS dhe Total Station”, me Nr. të Prok: 632-20-3153-1-2-1, nxjerr:

V E N D I M

Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik “DWH ALBANIA” sh.p.k, e dt. 01.09.2020, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pajisje të instrumentit GPS dhe Total Station”, me Nr. të Prok: 632-20-3153-1-2-1, Nr. Brendshëm 632-20-044-121., kundër kundër Njoftimit për kontratë dhe Dosjes së tenderit, të AK –së, të datës 01.09.2020, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. Vërtetohet NJOFTIM PËR KONTRATË DHE DOSJA E TENDERITI AUTORITETIT KONTRAKTUES të publikuar me datë: 01.09.2020;

1. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit;
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <http://www.e-prokurimi.rks-gov.net/>

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik “DWH ALBANIA” sh.p.k., me datë 01.09.2020, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me pajisje të instrumentit GPS dhe Total Station”, me Nr. të Prok: 632-20-3153-1-2-1, Nr. Brendshëm 632-20-044-121.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 04.09.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

1. Po e ri përsërisim dhe njëherë, ne afishimet e me hershme të specifikave teknike, ju si OE I interesuar keni bërë ankese që ne kemi specifikuar sinjalet dhe "ne kemi ngushtuar garën" duke I specifikuar një e nga një, tani me që ne vendosem ti përgjigjemi vendimit të OSHP-se që sinjalet të hiqen pra të hapet gara në pafundësi duke specifikuar vetëm konstipacionet dhe asnjë sinjal pa e specifikuar në veçanti, që do të thotë ne kërkuam 4 konotacione me të gjithë sinjalet që ofron prodhuesi, pra nëse prodhuesi juaj ofron dicka me shumë ose me pak ju e kaloni si përmbushje të kësaj specifikave sepse ne nuk jemi këtu për të bërë filtrime të produkteve të të gjithë prodhuesve që mund të jenë me qindra nëpër bote, por jemi për të marrë produktin me të mirë të mundshëm për institucionin tuë! Pra, e rihesojmë marrësin GNSS duhet të jetë I afte ti ndjek të gjithë konstelacionet dhe të ketë të instaluar të gjitha sinjalet sic janë të paraqitura në datasheetin e prodhuesit!

Pra, nuk ka asnjë diskriminim në këtë pikë!

2. E njëjta gjë po përsëritet, ne afishimet e mëparshme në ju kemi vënë në dispozicion disa prodhues që ofrojnë Windows 10, aq më tepër edhe vete prodhuesin që ju e përfaqësoni, po ta rikujtojmë dhe njëherë:

<https://leica-geosystems.com/products/total-stations/controllers/leica-cs35>

Ne nuk arrijmë të kuptojmë një gjë, përderisa prodhuesi juaj e ofron një sistem të tillë ku është diskriminimi në specifikat këtu!? Buxhetin që ka komuna jone për këto produkte nuk do të thotë që ne të ulim kërkesën për të sjellë dicka me të lirë, ne duam me të mirë për institucionin tuë, dhe ne si inxhinierë e shohim të nevojshëm sistemin operativ Windows 10, pse duhet ta ulim atë kur cdo prodhues e ofron një të tillë?

Ne gjykojmë që ekuivalent nuk është Windows me Android!

3. E ripërsërisim dhe njëherë, për një INXHINIER asnjëherë nuk është periferik kontrolleri është po aq I rëndësishëm sa vete GPS sepse pa njëra tjetrën nuk punojnë!

Po I njëjti kontrollor I juaji <https://leica-geosystems.com/products/total-stations/controllers/leica-cs35>.

4. E ripërsërisim, cdo produkt që ka një Ekran duhet të ketë IP sa me të madhe, dhe kjo është arsyeja pse ne zgjedhim që të ketë IP me të madhe! Pra është në të mirë tuë, dhe nuk mund të ulim kërkesën për një gjë kaq të rëndësishme. Ju kemi përcjellë disa broshura në ankesat paraprake që kjo specifikat është e plotësueshme nga dia prodhues.

5. Saktësia 1 deri 5 është për të hapë garën, me që ka ankesa tërë kohë dhe humbja e kohës me pyetje dhe përgjigje çdo ditë është humbje për institucionin tuë dhe për këtë arsye është bërë nga 1 deri në 5", sigurisht do të jetë I mirëseardhur 1", sa me të madhe saktësia aq më mirë për ne!

6. Cdo datasheet që ne kemi konsultuar thotë: matje me laser (pa prizëm) deri 4 metër, pra sic dihet matjet me laser bëhen zakonisht në mure, fasada sigurisht në xhamë jo!

7. Nuk kemi nxjerrë specifikat për saktësinë në matje me laser, nuk e kuptojmë pse duhet të bëhet një pyetje për diçka që nuk diskriminon askënd!

8. Datash et që janë konsultuar janë nga prodhuesit më poshtë:

- Leica,
- Trimble
- Topcon
- Hi-Target

- GeoMAX
- Stonex

Mendojmë qe qëllimi I ankesës duhet te jete për specifika nëse diskriminohet një OE ose prodhues, dhe nuk është qëllimi për te ule kërkesën e AK-se!

AUTORITETIT KONTRAKTUES mbetet pranë NJOFTIM PËR KONTRATË DHE DOSJES SË TENDERITI të publikuar me datë: 01.09.2020.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara
Arkivit të Komunës

Faton Gutaj
Menaxher i Zyrës së Prokurimit

